

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 2177 REP.

NR. 460/ KOL.

13



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Moligix Sh.p.k."**

Sot më datë 06.06.2017, para meje Noteres Anila Gjermeni, u paraqitën Palët e mëposhtme:

- MC Networking sh.p.k., me seli ligjore në Shqipëri, Tiranë, Njësia bashkiake nr. 5, Rr. Pjetër Bogdani 3, me NUIS K722230070, përfaqësuar nga administratori Z. Endri Meksi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 01.07.1979, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 0254462665 dhe nr. personal H90701154E;
- Admiral Sportwetten GmbH, me seli ligjore të regjistruar në Austri, 2352 Gumpoldskirchen, Novomatic Strase 5 dhe regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare nga Gjykata Rajonale në Wiener Neustadt me numrin 39714d, përfaqësuar nga Z. Endri Meksi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 01.07.1979, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 0254462665 dhe nr. personal H90701154E, në bazë të vendimit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Admiral Sportwetten GmbH i datës 22.05.2017;
- ATSI spolka akcyjna, me seli të regjistruar në Poloni, Krakowska, nr. 368, 32 – 080 Zabuerow, regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Gjykatës Kombëtare (KRS) me numrin KRS 0000029471, me libër regjistri të mbajtur në Gjykatën e Rrethit Krakow – Srodmiescie në Krakow, Divizioni XII Tregtar i Regjistrin të Gjykatës Kombëtare, përfaqësuar nga Z. Endri Meksi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 01.07.1979, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 0254462665 dhe nr. personal H90701154E, në bazë të vendimit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë ATSI spolka akcyjna i datës 22.05.2017,

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1 – Emërtimi

Shoqëria emërtohet Moligix Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria").

Neni 2 – Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Pjetër Bogdani 3, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë deri në 31 dhjetor të vitit 2080 dhe mund të zgjatet edhe më tej me vendim të Asamblese se Përgjithshme.

A handwritten signature in blue ink, likely of the notary, located at the bottom right of the page.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarë kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në vijim: Projektimin, financimin, ndertimin, implementimin dhe mirembajtjen e Sistemit Qendror të Monitorimit On-Line (SQMO) të industrisë së lojrave të fatit në Republikën e Shqipërisë si dhe cfaredolloj aktiviteti tjetër dytesor, komplementar, plotësues të nevojshëm ose të pershtatshëm në lidhje me sa më sipër me kusht që të jete i lejuar nga ligji.
- 4.2 Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në *consortium*-e edhe të përkohshme, *joint venture* ose (ii) të zotëroje, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të; jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- 4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 500,000.00 (peseqindmije) Lekë dhe është aktualisht i ndarë në 3 (tre) kuota si më poshtë. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 5.2 Kapitali themeltar është i nënshkruar si më poshtë:
- MC Networking sh.p.k, me seli ligjore në Shqipëri Tiranë, Njësia bashkiake nr. 5, Rr. Pjetër Bogdani 3 dhe NUIS K722230070, për vlerën 490.000 (katërqind e nëntëdhjetëmijë) Lekë, e cila përfaqëson 98% të kapitalit të Shoqërisë;
 - Admiral Sportwetten GmbH, me seli ligjore të regjistruar në Austri, 2352 Gumpoldskirchen, Novomatic Strase 5 dhe regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare nga Gjykata Rajonale në Wiener Neustadt me numrin 39714d, për vlerën 5,000 (pesë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 1% të kapitalit të Shoqërisë;
 - ATSI spolka kacyjna, me seli të regjistruar në Poloni, Krakowska, nr. 368, 32 – 080 Zabuerow, regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve të Gjykatës Kombëtare (KRS) me numrin KRS 0000029471, me libër regjistri të mbajtur në Gjykatën e Rrethit Krakow – Srodmiescie në Krakow, Divizioni XII Tregtar i Regjistrin të Gjykatës Kombëtare, për vlerën 5,000.00 (pesë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 1% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 6 – Transferimi i kuotave

Kuotat transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 7 – Administrimi



- 7.1 Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
- Dhurata Mexsi, e datëlindjes 05/10/1953 dhe e identifikuar me kartën e identitetit nr. 029357692 dhe nr. personal F360050230.
- 7.2 Administratorit i takon përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve, në gjykatë, dhe i takojnë kompetencat e administrimit të zakonshem të Shoqërisë në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji Tregtar") dhe në çdo rast në përputhje dhe në kufijtë e kompetencave të përcaktuar në vendimin e emërimit dhe/ose në nenin 12 të Statutit. Në lidhje me administrimin e jashtezakonshem të Shoqërisë, Administratori mund të veprojë pasi të jetë autorizuar shprehimisht nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve, të cilëve mund t'u delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 7.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ajo është gjithashtu e autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e saj personave të tjerë.

Neni 8 – Gjuha


Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën angleze. Për çdo konflikt që rrjedh nga zbatimi dhe/ose interpretimi i këtij akti, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.

* * * * *

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët e paraqitura, në prani dhe të përkthyesit, deklaruan se ky Akt Themelimi është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruan atë në praninë time, Noteres, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noterja vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

ORTAKËT


Për MC Networking sh.p.k.


Endri Mexsi


Për Admiral Sportwetten GmbH


Endri Mexsi

Për ATSI spolka akcyjna


Endri Mexsi

PËRKTHYES


Blelino Nikollo

NOTERI


NOTERE
Anila GJERMENI

SHTOJÇA 1
STATUTI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Moligix Sh.p.k.”

KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

Neni 1 – Emërtimi

- 1.1 Shoqëria emërtohet Moligix Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”).

Neni 2 – Forma

- 2.1 Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe Aktit të saj të Themelimit.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjisllacionit shqiptar në fuqi.

Neni 3 – Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga Pjeter Bogdani 3, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresa të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Organi administrativ mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale, degë, agjenci, zyra përfaqësimi si dhe cfaredolloj entiteti tjetër të çdo lloji.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të pershkruara në vijim: Projektimin, financimin, ndertimin, implementimin dhe mirembajtjen e Sistemit Qendror të Monitorimit On-Line (SQMO) të industrisë së lojrave të fatit në Republikën e Shqipërisë si dhe cfaredolloj aktiviteti tjetër dytesor, komplementar, plotësues të nevojshëm ose të pershtatshëm në lidhje me sa më sipër me kusht që të jete i lejuar nga ligji.
- 4.2 Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në *consortium*-e edhe të përkohshme, *joint venture* ose (ii) të zotëroje, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të; jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- 4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial



e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër të pranuar nga ligji.

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë deri në 31 dhjetor të vitit 2080 dhe mund të zgjatet edhe më tej me vendim të Asamblese së Përgjithshme.

KAPITULLI II KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Neni 6 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 500,000.00 (peseqindmije) Lekë dhe është aktualisht i ndarë në 3 (tre) kuota si me poshte. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 6.2 Kapitali themeltar është i nënshkruar si me poshtë:
- MC Networking sh.p.k., me seli ligjore në Shqipëri Tirane, Njesia bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani 3 dhe NUIS K722230070 për vlerën 490.000 (katerqind e nentëdhjetëmije) Lekë e cila përfaqëson 98% të kapitalit të Shoqërisë;
 - Admiral Sportwetten GmbH, me seli ligjore të regjistruar në Austri, 2352 Gumpoldskirchen, Novomatic Strase 5 dhe regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare nga Gjykata Rajonale në Wiener Neustadt me numrin 39714d për vlerën 5,000 (pese mijë) Leke e cila përfaqëson 1% të kapitalit të Shoqërisë;
 - ATSI spolka akcyjna, me seli të regjistruar në Poloni, Krakowska, nr. 368, 32 – 080 Zabuerow regjistruar në regjistrin e ndermarrjeve të Gjykatës Kombëtare (KRS) me numrin KRS 0000029471, me liber regjistri të mbajtur në Gjykatën e Rrethit Krakow – Srodmiescie në Krakow, Divizioni XII Tregtar i Regjistrimit të Gjykatës Kombëtare për vlerën 5,000.00 (pese mijë) Leke e cila përfaqëson 1% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë

- 7.1 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, kurdo dhe për më shumë se një herë, përmes kontributit në para apo në natyrë apo në kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.
- 7.2 Në rast zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit në proporcion me kuotat që ata zotërojnë. Vendimi i Asamblese së Përgjithshme që vendos për zmadhimin e kapitalit duhet të vendos edhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet shlyerja e tij. Në rast se zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet nga ana e të gjithë ortakëve brenda afatit të përcaktuar në vendim, atëherë pjesa e kapitalit të panënshkruar mund të nënshkruhet dhe shlyhet proporcionalisht nga ortakët e tjerë. Vetëm nëse këta ortakë nuk e ushtrojnë këtë të

drejte, pjesa e zmadhimit te kapitalit akoma e panenshkuar dhe e pashlyer mund t'i ofrohet te treteve. Vendimi perkates i Asamblesë se Ortakeve rregullon termat dhe kushtet e tjera te zmadhimit te kapitalit.

- 7.3 Nëse kapitali i Shoqërisë nuk nënshkruhet dhe shlyhet tërësisht, kapitali zmadhohet me një vlerë të barabartë me nënshkrimet dhe shlyerjet e mbledhura, vetëm nëse vendimi përkatës i Asamblesë së Përgjithshme e ka parashikuar shprehimisht.
- 7.4 Zmadhimi i kapitalit nuk mund të kryhet deri në momentin kur kuotat e emetuara më parë të jenë shlyer tërësisht.

Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë

- 8.1. Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 8.2. Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9 – Transferimi i kuotave

- 9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe në favor të të tretëve, përveç sa parashikohet shprehimisht në këtë nen.
- 9.2 Në rast transferimi, teresor ose të pjesshëm të kuotave në favor të të tretëve, ortakët e tjerë të Shoqërisë kanë të drejtë parablerje.
- 9.3 Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë pronësinë e kuotës së tij ose një pjesë të saj në favor të të tretëve duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë, mbi synimin për transferimin e pronësisë, duke përcaktuar çmimin, kushtet dhe afatet e pagesës së tij dhe emrin e përfituesit.
- 9.4 Ortakët e tjerë do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga marrja e njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotën, synimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes mbi kuotën e ofruar kundrejt të njëjtit çmim sipas njoftimit. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen në afatin e caktuar me sipër, prezumohet se kanë hequr dorë nga ushtrimi i se drejtes se parablerjes.
- 9.5 E drejta e parablerjes i takon ortakut edhe në rastin e dhurimit të kuotave të tretëve.
- 9.6 E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet vetëm për një pjesë të kuotave të ofruara për transferim.
- 9.7 E drejta parablerjeje nuk mund të ushtrohet në rast të transferimit të kuotave midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.8 Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, atëherë kuotat e ofruara për shitje do të blihen nga ortakët në proporcionin e drejtë me pjesëmarrjen e tyre në Shoqëri.
- 9.9 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'i transferohen lirisht të



- tretëve te percaktuar ne njoftimin e parashikuar nenin 9.3 me siper kundrejt cmimit dhe afateve dhe kushteve te pageses se parashikuar aty.
- 9.10 E drejta e parablerjes nuk mund te ushtrohet ne rastin kur subjekti te cilit do t'i transferohen kuotat eshte (i) nje shoqeri drejtpersedrejti ose terthorazi e kontrolluar nga ortaku qe ka si qellim te transferoje kuotat ne fjale, (ii) nje shoqeri ose individ i cili drejtpersedrejti ose terthorazi kontrollon ortakun qe ka si qellim te transferoje kuotat ne fjale ose (iii) subjekti te cilit do t'i transferohet pronesia e kuotave dhe ortaku qe ka si qellim te kryeje kete transferim jane te dy nen kontrollin e perbashket te nje shoqerie te trete. Ne kete rast ortaku qe ka si qellim te transferoje kuotat duhet te njoftoje me shkrim ortaket e tjere duke bashkangjitur dokumentacionin qe provon lidhjen e mesiperme. Per me shume qartesi, ne kuptimin e kesaj dispozite, "kontroll" do te thote te kesh ne pronesi direkt ose indirekt shumicen absolute te totalit te votave (pra 50%+1).
- 9.11 Trasferimi i kuotave në favor të të tretëve është i pavlefshëm dhe nuk ka efekt nëse nuk kryhet sipas parashikimeve të këtij neni.
- 9.12 Ortaket nuk mund te vene peng ose barre siguroese mbi kuotata e Shoqerise qe kane ne pronesi pa marre miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve te Shoqerise.
- 9.13 Derisa ortaket e pakices qe jane themelues te Shoqerise te kene ne pronesi deri ne (por jo me shume se) 1% te kapitalit themeltar te Shoqerise, ne cdo moment, por jo me heret se 6 muaj nga momenti ne te cilin Shoqeria e ka filluar te faturoje nga *core business* i saj dhe jo me vone se 10 vjet, secili prej ortakeve te pakices, ne menyre te pavarur, do te kete te drejte qe t'i transferoje ne menyre te pakthyeshme ortakut te shumices pronesine e te gjithë kuotes se Shoqerise ne pronesi ("**Kuota Target**") kundrejt nje vlere dhe menyre pagese qe palet perkatese do te bien dakord me shkrim *a latere* dhe ortaku i shumices do te kete detyrimin per te blere Kuoten Target ne baze te vleres se konkorduar si me siper ("**Opsioni Put**"). Pronesia e Kuotes Target do te kaloje nga ortaku i pakices tek ortaku i shumices menjehere pasi ky i fundit t'i kete paguar ortakut te pakices vleren e konkorduar. Opsioni Put do të ushtrohet nëpërmjet një njoftimi të shkruar (letër rakomande me kthim pergjigje) te cilin ortaku i pakices (qe ka si qellim te ushtroje kete opsion) ia dërgon ortakut te shumices duke vene ne dijeni edhe ortakun tjetër te pakices ("**Njoftimi Put**"). Ne Njoftimin Put duhet të percaktohet noteri pranë së cilit do të nënshkruhet kontrata e transferimit të kuotes, data dhe ora në të cilën palët duhet të paraqiten përballë noterit të sipër-përcaktuar (kjo datë duhet të përfshihet brenda ditës së 30-të (tridhjetë) dhe 45-të (dyzet e pese) kalendarike pas marrjes së Njoftimit Put nga ortaku i shumices). Nese per cfaredolloj arsye, ortaku i shumices refuzon te kryeje sa me siper dhe, si rrjedhim, nuk blen Kuoten Target, ai do t'i paguaje ortakut te pakices nje penale te barabarte me pesefishin e cmimit te konkorduar me siper.



KAPITULLI III
ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

Neni 10 – Asambleja e ortakëve, të drejtat e pjesëmarrjes dhe votës, thirrja

- 10.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e ortakëve.
- 10.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e ortakëve, të shpreh mendimin e tij dhe ka të drejta vote në përfaqësimin me vlerën nominale të kuotes në pronësinë e tij. Ortaku nuk mund të votojë në një mënyrë me një pjesë të kuotes dhe në një mënyrë tjetër me pjesën e mbetur të saj.
- 10.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, edhe jo ortak, i pajisur me një autorizim të thjeshtë, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, autorizimi do të mund të lëshohet vetëm për një Asamble ortakësh, dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë.
- 10.4 Ortaku nuk mund të japë autorizim për të votuar për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj.
- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërkohet nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkesë të shkruar drejtuar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda muajit të qershorit, me qëllim që të diskutojë dhe miratojë bilancin vjetor të vitit të mëparshëm fiskal.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike me evidencë marrje dërguar ortakëve në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 10.8 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mbledhet.
- 10.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me autorizim dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të


5

- ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës.
- 10.11 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari.
- 10.12 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, të lidhur me video/telekonferencë nën kujdesin e Shoqërisë, ku ortakët do të mund të mblidhen.
- 10.13 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i zgjedhur nga ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e nevojshme, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë ortak.
- 10.14 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë autorizimet dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblesë të Përgjithshme dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmerisht. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 10.15 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përgatiten menjëherë pas mbajtjes së saj dhe duhet të nënshkruhen prej Kryetarit dhe Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga ligji dhe regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.
- 10.16 Pavarësisht nga sa me sipër, një vendim i Asamblesë së Përgjithshme mund të merret vlefshmerisht edhe me anë të një vendimi qarkullues me shkrim me kusht që ky vendim qarkullues të nënshkruhet nga të gjithë ortakët. Propozimi i vendimit me të gjithë dokumentacionin e nevojshme sqarues bashkëngjitur duhet t'i dërgohet me rrugë të gjithë ortakëve, me çdo mjet të pershtatshëm që provon marrjen e tij nga këta të fundit. Nga propozimi duhet të rezultojë në mënyrë të qartë çështja në rend të ditës dhe gjithë sa është e nevojshme për të siguruar informacionin e duhur mbi çështjen në fjalë, si dhe teksti përfundimtar i vendimit që duhet nënshkruar. Nënshkrimi i vendimit nga secili prej ortakëve shpreh pozicionin përkatës të secilit prej tyre. Kuorumi i vendimarrjes është ai që është i parashikuar në nenin 11 të Statutit. Do të konsiderohet date e vendimarrjes data në të cilin është materializuar nënshkrimi i ortakut të fundit. Këto vendime dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruar që shpreh vullnetin e tyre duhet të regjistrohen në librin e vendimeve të Shoqërisë.

Neni 11 – Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është kompetente për të vendosur mbi të gjitha çështjet që ligjet në fuqi dhe Statuti i rezervojnë asaj.



- 11.2 Asambleja e Përgjithshme mblidhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro të 51% (pesëdhjetenjë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur ligji ose ky statut parashikojnë ndryshe.
- 11.3 Pa cënuar sa më sipër, në lidhje me çështjet e mëposhtme Asambleja e Përgjithshme mblidhet rregullisht dhe mund të marrë vendime të vlefshme me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatëdhjetepesë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë:
- (i) modifikimi i Statutit;
 - (ii) zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
 - (iii) riorganizimi, likuidimi dhe prishja e Shoqërisë ose revokimi i vendimeve në lidhje me veprimet në fjale;
 - (iv) bashkimi, përthithja ose ndarja e Shoqërisë;
 - (v) vendimet për miratimin e dividendeve dhe shpërndarja ose mosshpërndarja e tyre.

Neni 12 – Administratori/ët

- 12.1 Shoqëria mund të administrohet nga një apo më shumë Administratorë me të drejtën që të veprojnë bashkërisht ose veçmas sipas përcaktimit dhe kufijve të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.2 Administratorët mund edhe të mos jenë ortakë. Ata qëndrojnë në detyrë deri në dhënien e dorëheqjes apo deri në momentin e revokimit prej Asamblesë së Përgjithshme ose për një kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh nga momenti i emerimit dhe janë të rimbursueshëm. Nëse në përfundim të afatit 3 (tre) vjeçar, nuk është mbledhur Asambleja e Përgjithshme për të emëruar Administratorin/et e rinj, Administratori do të vazhdojë në detyrë me tagra të plota deri në mbledhjen e rradhes të Asamblesë së Përgjithshme që voton për emerimin e Administratorit të ri.
- 12.3 Administratorëve u takon përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve, në gjykatë, dhe u takojnë kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (“Ligji Tregtar”) dhe në çdo rast në përputhje dhe në kufijtë e kompetencave të përcaktuara në vendimin e emerimit dhe/ose në këtë Statut. Në lidhje me administrimin e jashtëzakonshëm të Shoqërisë, Administratorët mund të veprojnë pasi të jenë autorizuar shprehimisht nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Administratorët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë të posaçme për akte ose kategori aktesh, brenda kufijve të kompetencave të deleguara nga ky Statut, ligj dhe vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.5 Detyra e Administratorit është pa pagesë, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe. Administratorëve iu takon rimbursimi i shpenzimeve të mbajtura si pasojë e ushtrimit të pozicionit të tyre.



7

- 12.6 Administratoret kane per detyre te informojne ortaket e Shoqerise dhe njeri tjetrin (ne rastin kur ka me shume administratore qe veprojne vec e vec) ne lidhje me veprimtarine e tyre, te pakten cdo tre mua ose ne vijim te kerkeses se ortakeve.

KAPITULLI IV

EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 13 – Eksperti kontabël i regjistruar

- 13.1 Nëse kërkohet nga ligji apo një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një apo më shumë ekspertëve kontabël të regjistruar.
- 13.2 Eksperti kontabël i regjistruar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga ligjet në fuqi.

Neni 14 – Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 14.2 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe raporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e votave të kërkuar në paragrafin 11.2 më sipër.
- 14.3 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 15 – Fitimet

- 15.1 Me kusht qe te jete respektuar neni 77 i Ligjit Tregtar, fitimet neto që rezultojnë nga bilanci vjetor i Shoqerise - pasi i është zbritur edhe e gjithë shuma që Asambleja e Përgjithshme vendos lirisht të vërë mënjanë si rezerva diskrecionale, me voten pro te ortakeve te parashikuar ne nenin 11.3 me siper - i shpërndahen ortakëve proporcionalisht me kuotat në kapitalin e Shoqërisë që ata kanë perkatesisht në pronësi.
- 15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë lirisht të mbajë te gjithë fitimet ose ne j pjese te tyre si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve – tërësisht apo pjesërisht – në vitet ushtrimore pasardhës.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 16 – Shpërndarja

- 16.1 Shoqëria shpërndahet në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën e parashikuar për modifikimin e Statutit të Shoqërisë.

Neni 17 – Likuidimi



- 17.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në likuidim.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme e ortakëve do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivitetit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e ortakëve do të marrë vendim në lidhje me bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 17.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 18 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Statuti dhe mes Shoqërisë dhe ortakëve apo mes ortakëve, do të lihen nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

Neni 19 – Dispozitat ligjore në fuqi

- 19.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.


* * * * *

ORTAKËT

Për MC Networking sh.p.k.


Endri Meksi


Për Admiral Sportwetten GmbH


Endri Meksi


Për ATSI spolka akcyjna


Endri Meksi

PËRKTHYES


Blelino Nikollo

NOTERI


NOTERE
Anila GJERMENI